

## Syllabusi i lëndës: Psikologji Edukimi e Avancuar

Të dhëna bazike të lëndës	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Filozofik – Departamenti i Psikologjisë</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Psikologji edukimi e avancuar</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Master</b>
<b>Statusilëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Për tu definuar</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Dr. Aliriza Arënlju</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b><a href="mailto:Aliriza.arenliu@uni-pr.edu">Aliriza.arenliu@uni-pr.edu</a></b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Lënda është konceptuar si vazhdim, avancim i përmbajtjeve lëndore të trajtuara në lëndën “Psikologji edukimi” e programit baçelor. Lënda do të ofrojë analiza të thukta dhe hollësishme të teorive dhe praktikës bashkëkohore të të nxënit, duke trajtuar gjerësisht hulumtimet kryesore më të fundit të psikologjisë së edukimit dhe më specifikisht në të nxënit, motivacionin, zhvillimin e identitetit, disiplinën dhe vlerësimin. Kursi është dizajnuar për t’u përshtatur nevojave të studentëve që planifikojnë të involvohen në kontekste të edukimit, në mënyrë që të sigurojë informacionet më të reja lidhur me proceset e të mësuarit dhe nxënit. Poashtu supozohet që përmbajtja e kursit t’u mundësojë studentëve të zhvillojnë teori dhe praktika të edukimit duke u bazuar në konceptet teorike dhe gjetjet e hulumtimeve nga kjo lëmi.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Kursi synon që të ekzaminojë thellësisht teoritë kryesore të Psikologjisë së edukimit të avancuar (teorinë Bihevisoriste, Kognitive, Sociale, teorinë e procesimit të informacioneve, proceset Kognitive të të mësuarit, teoritë e motivimit, etj), me qëllim që t’u mundësojë studentëve të ndërtojnë dhe rindërtojnë teoritë personale të të mësuarit përgjatë këtij kursi. Kursi poashtu synon të shqyrtojë çështje të ndryshme që lidhen me kohën moderne të psikologjisë së edukimit, përmes trajtimit të temave të ndryshme, si: efektivitetin e stimuljeve të jashtëm në procesin e të mësuarit; temave që kanë të bëjnë me inetrësimin dhe përkushtimin e studentëve në procesin mësimor, natyrën e inteligjencës dhe kreativitetit; rrethanat (kushtet) që ndikojnë në mirëqenien e studentëve; relacioni ndërmjet të mësuarit</p>

	dhe të nxënit; dallimet kulturore dhe etnike në të mësuarit; çështjet e testimit, vlerësimit dhe përgjegjësisë, etj. Në përgjithësi, kursi synon të theksojë se si teoria, praktika dhe hulumtimi, informojnë dhe ndikojnë njëra – tjetrën duke synuar që të përmirësojnë përpjekjet e edukatorëve.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Përshkruajnë procesin dhe rëndësinë e zhvillimit të teorive në kërkimin e dijes brenda shkencave të sjelljes; të analizojnë teoritë kryesore të të mësuarit dhe të nxënit, si dhe aplikimin e tyre në kontekstet e edukimit; të identifikojnë drejtimit aktuale të rëndësishme si dhe çështjet e teknologjisë edukative; të zhvillojnë një listë të tyre të parimeve të rëndësishme të të nxënit dhe instruksioneve bazë.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësuesin/konsultimet			5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim			10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			5
Projektet,prezentimet ,etj			5
<b>Totali</b>			<b>150</b>

<b>Metodologjia e mësimëdhënies:</b>	Kursi do të realizohet përmes ligjeratave të rregullta, interaktive, me metoda më të avancuara, ushtrimeve praktike, diskutimeve në grup, involvimin në prezantime dhe raste të studimit, punime të tjera të temave relevante me kursin, punë ekipore për analizimin dhe zhvillimin e mini hulumtimeve lidhur me temat e studimit, konsultime gjatë gjithë semestrit, etj.
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vijimi dhe konsultimet e rregullta: 10% Angazhimi në punë ekipore: 30% Provimi final: 60%
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	Dandapani, S. (2005). A textbook of Advanced Educational Psychology, Anmol publications  Kuppuswamy, B.(2008) Advanced Education Psychology. Sterling Publishers (P) Ltd.  Woolfolk, A., Perry, N. (2012). Child and Adolescent Development , University of British Columbia.
<b>Literatura shtesë:</b>	Woolfolk, A. (2006). Educational Psychology, Allyn & Bacon.  Joyce, B., Weil, M, with Calhoun, E. (2000). Models of teaching (6th ed.). Boston: Allyn & Bacon.  Langer, E.J. (1997). The power of mindful learning. Cambridge, MA: Perseus

<b>Plani i detajuar i edukimit për një semestër</b>	
<b>Java</b>	<b>Tema</b>
<b>Java 1;</b>	Fushëveprimi i Psikologjisë së Edukimit
<b>Java 2;</b>	Natyra dhe Faktorët e Zhvillimit; Natyra dhe Proceset e të Mësuarit
<b>Java 3;</b>	Motivimi dhe të Mësuarit
<b>Java 4;</b>	Zhvillimi i shkathtësive motorike dhe Dijes; Perceptimi dhe Konceptimi; Interesimet dhe Qëndrimet
<b>Java 5;</b>	Psikologji e dallimeve Individuale
<b>Java 6;</b>	Teoritë e Inteligjencës; Matjet e Inteligjencës

<b>Java 7;</b>	Matjet Edukative dhe Vlerësimi
<b>Java 8;</b>	Zhvillimi dhe Vlerësimi i Personalitetit
<b>Java 9;</b>	Psikanaliza dhe Edukimi
<b>Java 10;</b>	Proceset Grupore në Klasë
<b>Java 11;</b>	Higjiena Mentale dhe Edukimi
<b>Java 12;</b>	Fëmijët me sjellje të papërshtatshme
<b>Java 13;</b>	Psikologji e Disiplinës
<b>Java 14;</b>	Udhëzimi Edukativ dhe Profesional
<b>Java 15;</b>	Fëmijët me sjellje të këqija ; Edukimi i fëmijëve me dhunti
<b>Definimi i përbashkët i rregullave me studentët:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënësi do të ndihmojë të nxënit e studentëve dhe arritjet e qëllimeve të lëndës përmes vlerësimit të progresit të studentëve në vazhdimësi dhe në një mënyrë që ju ofron atyre prapaveprim (feedback) të përdorshëm;</li> <li>- Studentët janë fuqimisht të inkurajuar që të bëjnë pyetje, të komentojnë dhe të marrin pjesë në diskutimet klasore;</li> <li>- Sjellja e duhur akademike është e domosdoshme. Kopjimi i punës së të tjerëve, përdorimi i materialeve të pa-aprovuara gjatë provimeve dhe kuizeve, apo marrja (duplikimi) e/i punës së tjetrit paraqet mashtrim dhe nuk do të tolerohet;</li> <li>- Përdorimi i lap-topëve (kompjuterëve) lejohet vetëm me aprovimin paraprak të mësimdhënësit;</li> <li>- Përdorimi i telefonave mobil nuk është i lejuar;</li> </ul>	